



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pzd.nr.116/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare kolegj, Mejreme Memaj dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit E. (A.) Xh. nga fshati T., komuna e P., me vendbanim në lagjen K. e T., rruga “Sh. H.” nr..., Prishtinë, për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 275 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkritazi me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të dënuarit, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të dënuarit E. Xh., për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë PK.nr.154/2023 të datës 18.01.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin PK.nr.154/2023 e datës 18.01.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e të dënuarit E. Xh., për bashkimin e dënimeve e ka aprovuar si të bazuar kërkesën dhe ka ndryshuar: aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i për krime të rënda PKR.nr.163/2022 të datës 25.07.2023, me të cilin i dënuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 275 të KPRK-së, dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj, dhe dënim me gjobë në shumën prej 100 (njëqind) euro, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda PKR.nr.68/2021 i datës 18.08.2021 me të cilin i dënuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 269 par.1, lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.8 të KPRK-së, dhe për këtë veprë penale është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumën

prej 200 (dyqind) euro, të cilën është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Andaj, qe konform dispozitës së nenit 420 par.1, 2 e 5 të KPP-së lidhur me nenin 76 të KPRK-së, të dënuarit E. Xh., për të këto vepra penale i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 1 (një) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur i dënuari U. K., me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar dhe t'i zbutet dënimi.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KZJD.nr.116/2024 e datës 14.10.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Pejë, me shkresën PK.nr.69/2024, e datës 25.09.2024, si dhe Prokuroria Themelore në Pejë, në përgjigjen PP/I.nr.12/2021 dhe PP/I.nr.130/2021 e datës 25.09.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë lejohet kur paraqiten rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë, vlerëson nëse rrethanat e reja që theksohen në kërkesë do të çonin në caktimin e një dënimi më të butë, po qe se ato do të ekzistonin me rastin e shqiptimit të dënimit në procedurën e rregullt, gjithmonë duke pasur parasysh peshën e veprës penale të kryer.

Në kërkesën e tij, i dënuari ka theksuar se që 8 (tetë) vite është në vuajtje të dënimit dhe se asnjëherë nuk ka përfituar falje, lirim me kusht apo beneficione, vetëm se rrjedh nga një familje e varfër ekonomikisht. Tutje ka theksuar se ka gabuar dhe është penduar për veprimet e tij, se nënën e ka të moshuar dhe të sëmurë, ndërsa vëllau i vuan nga kanceri për të cilin përkujdeset nëna dhe se prania e tij do të ishte e domosdoshme në familje, pasi që të njëjtit nuk kanë asnjë përkrahje morale e as materiale nga askush tjetër. Kërkesës nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me sëmundjen e pretenduar të vëllaut.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me rastin e vendosjes lidhur për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykatat kanë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimeve. Edhe pse në kërkesë potencohet gjendja jo e mirë shëndetësore e nënës dhe vëllaut të tij, megjithatë nuk është bashkangjitur asnjë dokument mjekësor, mbi bazën e të cilave

dokumente mund të vlerësohej besueshmërie e kërkesës. Në anën tjetër, pendimi dhe keqardhja e të dënuarit për veprën penale dhe premtimi edhe pse mund të merret si reale, nuk janë rrethana të reja në kuptim të dispozitës së nenit 429 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.7 të KPP-së, vendosi si në dispozitivë të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pzd.nr.116/2024, më datë 30.10.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka